



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

2007

PLANI I INTEGRUAR I MINISTRISË





## Mesazhi i Ministrit

Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) ka ndërmarrë disa reforma të cilat kanë si synim të kthejnë besimin e publikut te sistemi arsimor dhe të përmirësojnë cilësinë e shërbimit arsimor. Këto reforma kanë pasur mbështetjen e publikut si dhe vlerësimin e qarqeve profesionale.

Projekti "Cilësi dhe Barazi në Arsim", i mbështetur nga Banka Botërore dhe donatorë të tjerë, përbën prioritetin strategjik të MASH gjatë viteve 2007-2010, pasi harmonizon objektivat e Qeverisë për një arsim cilësor e për të gjithë me objektivat e strategjisë kombëtare të arsimit. Në hartimin e këtij projekti janë përfshirë institucionet qendrore dhe lokale, si dhe specialistë, nxënës, mësues, prindër, përfaqësues të shoqërisë civile.

Prioritetet dhe objektivat sektoriale, që paraqiten në planin e integruar të MASH për vitin 2007 e në vijim, marrin parasysh ndërthurjet me strategjitë e sektorëve të tjerë dhe ato ndërsektorale, veçanërisht ato që lidhen me decentralizimin e shërbimeve, zhvillimin e pritshëm ekonomik, uljen e varfërisë, zhvillimet demografike dhe eliminimin gradual të shpërpjesëtimeve rajonale, sigurimin e aksesit të barabartë për të gjithë fëmijët dhe mbështetjen e shtresave në nevojë.

*Genc Pollo*

Ministër i Arsimit dhe Shkencës

## Pasqyra e lëndës

|         |                                                   |    |
|---------|---------------------------------------------------|----|
| 1       | Misioni i Ministrisë.....                         | 2  |
| 2       | Dokumenta strategjike të Ministrisë .....         | 2  |
| 3       | Programet buxhetore të Ministrisë .....           | 5  |
| 4       | Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007.....   | 6  |
| 5       | Plani i Monitorimit të Ministrisë .....           | 11 |
| Aneks 1 | Projekt-ligjet për tu paraqitur .....             | 12 |
| Aneks 2 | Rezultate që lidhën me Programin e Qeverisë ..... | 14 |
| Aneks 3 | Rezultate që lidhën me integrimin European .....  | 15 |
| Aneks 4 | Rezultate që lidhën me anëtarisimin në NATO ..... | 17 |
| Aneks 5 | Investimet publike .....                          | 18 |
| Aneks 6 | Projekte të ndihmës së huaj .....                 | 19 |

# 1 Misioni i Ministrisë

## Politika e programit të arsimit dhe kërkimit shkencor

Sigurimi i një sistemi *arsimor cilësor, të integruar me kërkimin shkencor, që* mundëson shanse të barabarta për të gjithë shtetasit shqiptarë, i fokusuar në formimin e qytetarit me ndërgjegje demokratike dhe me njohuritë e nevojshme për t'u përballur me kërkesat e ekonomisë së tregut në përputhje me prioritetet kombëtare dhe evropiane .

## Qëllimi i politikave

- Edukimi i qytetarëve shqiptarë me vlerat demokratike dhe kombëtare ;
- Edukim i mbështetur në të drejtat e njeriut në përgjithësi dhe të fëmijëve në veçanti;
- Edukim cilësor që:
  - o respekton perspektivën dhe interesat e individit, të komunitetit dhe të shoqërisë,
  - o synon arritjen e standardeve arsimore evropiane,
  - o ofron njohuri dhe shprehi për t'u përshtatur me kërkesat e ekonomisë së tregut,
  - o rrit aksesin e komunikimit për zhvillim profesional e shkencor, duke u përfshirë në rrjetat njerëzore të bashkëpunimit, bazuar në zotërimin e shprehive dhe shkathtësive të nevojshme për përdorimin e ICT dhe gjuhës angleze.
- Sigurim i arsimit bazë për të gjithë;
- Përshtatje e vazhdueshme e sistemit të arsimit dhe kërkimit me zhvillimet kombëtare, evropiane e më gjerë;
- Krijimi i një rrjeti unik kërkimi dhe integrimi i kërkimit me mësimin në arsimin e lartë, bazuar në ristrukturimin e institucioneve kërkimore dhe në shndërrimin e universiteteve në qendra të kërkimit e të zhvillimit teknologjik, krahas procesit mësimor;
- Integrimi i veprimtarisë kombëtare të kërkimit e të zhvillimit teknologjik në veprimtarinë shkencore dhe teknologjike rajonale, evropiane dhe botërore;
- Zhvillimi dhe përdorimi efektiv i potencialeve njerëzore, arsimore dhe shkencore;
- Optimizimi i efektivitetit dhe efikasitetit të përdorimit të burimeve financiare;
- Performanca e qeverisjes së sistemit të arsimit dhe kërkimit

## 2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

### Strategjia sektoriale e arsimit parauniversitar

Zbatimi i strategjisë së arsimit parauniversitar 2004-2015, e rivlerësuar dhe në proces miratimi, është në fazën e implementimit të saj në kuadër të projektit "Cilësi dhe Barazi në Arsim". Ky projekt është zbatim i fazës së parë të Strategjisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe ka si objektiv të përgjithshëm përmirësimin e cilësisë të procesit mësimor dhe rritjen e numrit të regjistrirove nga shtresat e varfra.

### Strategjia sektoriale e arsimit të lartë

Përgatitja dhe miratimi i strategjisë afatgjatë të zhvillimit të arsimit të lartë përfaqëson synimin e MASH në këtë fushë për periudhën 2006-2007. Ky dokument synon institucionalizimin e reformimit të arsimit të lartë në strukturë, në përmbajtje, menaxhim dhe administrim, nëpërmjet zbatimit gradual të procesit të Bolonjës. Afrimi me standardet evropiane dhe unifikimi i kërkimit me mësimin në arsimin e lartë përbën zhvillimet kryesore në këtë fushë për periudhën 2006-2007.

### Qëllime

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të mëposhtme afatgjata:

- Përmirësimi i kapaciteteve dhe aftësive menaxhuese në nivelin qendror (MASH), rajonal (DAR dhe ZA), lokal (shkollat) si dhe i institucioneve që varen nga MASH.
- Decentralizimi i shërbimit arsimor dhe rritja e autonomisë së shkollave
- Instalimi i sistemit të menaxhimit të informacionit në shërbimin arsimor (EMIS).
- Reformimi i sistemit të financimit dhe rritja e kapaciteteve përkatëse në të gjitha nivelet.
- Përmirësimi dhe racionalizimi i infrastrukturës së shërbimit arsimor
- Rritja e viteve të shkollimit, duke zgjatur periudhën e arsimit të detyruar nga 8 në 9 vjet, për të rritur mesataren e viteve të shkollimit të popullsisë nga 9.5 në 11.2 vjet, gjatë 10 vjetëve.
- Rritja e përqindjes së nxënësve që frekuentojnë arsimin e detyrueshëm në masën 99 % dhe arsimin parashkollor në masën 58%.
- Shtimi i numrit të shkollave dhe klasave si dhe përmirësimi i mjediseve shkollore me synim arritjen e kushteve optimale mësimore dhe pajisja e shkollave me mjete laboratorike didaktike dhe kompjuterë si dhe me pajisje të nevojshme shkollore.
- Rritja e rezultateve të shkollimit nëpërmjet zbatimit të standardeve të përmbajtjes dhe arritjes, si dhe standardeve minimale dhe maksimale të arsimit.
- Rritja e motivimit të punonjësve të sistemit arsimor dhe trajnimi dhe kualifikimi i vazhdueshëm i tyre.
- Të arrihet që në vitin 2010 tërheqja në arsimin e mesëm të arrijë në masën rreth 90% (përkundrejt masës 80% që është sot), me qëllim thithje në arsimin e mesëm të sa më shumë nxënësve, që mbarojnë arsimin e detyruar si dhe rritjen e viteve mesatar të shkollimit
- Të përmirësohet infrastruktura shkollore, nëpërmjet ndërtimit të shkollave të reja, rehabilitimit të shkollave ekzistuese dhe zgjerimit të kapaciteteve të tyre si dhe pajisja e shkollave me orenditë e nevojshme me qëllim uljen në nivelet deri në 30 nxënës për klasë
- Të zbatohet në të gjithë sistemin e arsimit të mesëm të përgjithshëm kurrikula e re e arsimit të mesëm, me qëllim modernizimin në përmbajtje dhe metodë të kurrikulit shkollor si dhe

përgatitjen në perspektivë të qytetarëve të denjë dhe të aftë për shoqërinë demokratike të ekonomisë së tregut

- Zgjerimi i kapaciteteve ekzistuese dhe hapja e 2-3 degëve të reja për të ndikuar në rritjen e kërkesave për arsim profesional dhe social-kulturor, me synimin që të arrihet kuota e tërheqjes në këtë lloj arsimit të 40% të nxënësve të arsimit të mesëm. Arsimi profesional dhe social-kulturor t'u përgjigjet nevojave të tregut dhe të zonave të ndryshme të vendit në shërbimeve si hoteleri-turizëm, mirëmbajtje e riparim automjetesh, hidro-sanitare. Vlerësimi i arritjeve të nxënësve përmes provimeve e inspektimeve të ndryshme.
- Të rritet numri studenteve universitare dhe pasuniversitare duke rritur përqindjen e tërheqjes së maturantëve nga 18.000 kuota të reja në vitin 2006 në 23 000 kuota të reja në vitin 2009
- Çdo universitet të arrijë të mbulojë me të ardhurat e veta 30%-35% të nevojave akademike
- Të rritet mobiliteti i studenteve dhe pedagoqeve duke aplikuar sistemin e krediteve ECTS dhe "Shtojcën e diplomës"
- Të përmirësohen kurrikulat duke hartuar standardet bashkëkohore të kurrikulave dhe programeve mësimore.
- Të rritet numri i studentëve në ciklin e dytë të studimeve "master" në dy universitete
- Platforma Kombëtare për reformimin e sistemit të kërkimit shkencor.
- Institucionet kërkimore shkencore të integruara në programet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit si edhe në rrjetin e programeve evropiane të kërkimit shkencor.
- Implementimi i institucioneve dhe i biznesit privat në programet kombëtare dhe ndërkombëtare të kërkimit dhe zhvillimit.

## 3 Programet buxhetore të Ministrisë

### 3.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Politika e këtij programi konsiston ne reformimin dhe forcimin e kapaciteteve menaxhuese të sistemit arsimor.

### 3.2 ARSIMI BAZE (PËRFSHI PARASHKOLLORIN)

Politika e këtij programi konsiston ne sigurimin e kushteve te barabarta për pjesëmarrje ne arsimin e detyruar, për te gjithë fëmijët e moshës. Realizimin e reformës arsimore ne përmbajtje dhe metode, duke hartuar kurrikulën e re dhe duke zbatuar gjerësisht standardet e përmbajtjes dhe arritjes. Përmirësimin e menaxhimit te burimeve njerëzore, nëpërmjet rritjes se motivimit te mësuesve dhe trajnimit e kualifikimit te tyre. Zhvillimin sasior dhe cilësor te Arsimit Parashkollor. Matjen e performancës së sistemit arsimor nëpërmjet vlerësimeve dhe provimeve.

### 3.3 ARSIMI I MESËM (I PËRGJITHSHËM)

Politika e këtij programi konsiston ne rritjen e tërheqjes së nxënësve që mbarojnë arsimin e detyrueshëm në arsimin e mesëm të përgjithshëm, krijimin e kushteve optimale pune në shkolla, reformimin e përmbajtjes dhe metodave, përmirësimin e teknologjisë mësimore dhe motivimit të mësuesve, duke synuar rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

### 3.4 ARSIMI I MESËM (PROFESIONAL)

Politika e këtij programi konsiston ne reformimin e Arsimit të Mesëm Teknik-Profesional dhe Social-Kulturor sipas nevojave të tregut të punës dhe zhvillimeve të zonave të veçanta të vendit. Rritjen e numrit të nxënësve që studiojnë në këto kategori arsimit, përmes krijimit të mundësive të reja, hartimit të kurrikulave të reja në tërësi dhe me dy nivele në veçanti për arsimin profesional, si dhe zgjerimit të bashkëpunimit me biznesin dhe komunitetin. Përgatitjen më te mirë profesionale e nxënësve, duke ngritur reparte të reja të zhvillimit të praktikave profesionale, kabinete të ndryshme dhe pajisja e atyre ekzistuese me makineri e teknologji të nevojshme. Përshtatjen e strukturës së arsimit profesional dhe atij social-kulturor me sistemin e detyruar 9-vjeçar të arsimit.

### 3.5 ARSIMI UNIVERSITAR

Politika e këtij programi konsiston ne parimet dhe qëllimet e "Deklaratës së Bolonjës" për të arritur standardet evropiane. Në mënyrë të veçantë, prioritetet janë zgjerimi i kapaciteteve të arsimit të lartë universitar dhe pasuniversitar për t'iu përgjigjur nevojave te shoqërisë për kualifikim, rritja e cilësisë se mësimdhënies nëpërmjet përmirësimit të kurrikulave dhe pasurimit të bazës laboratorike dhe pajisjeve teknike, realizimi i autonomisë institucionale dhe financiare, përmirësimi i sistemit te bursave për t'i shpërndarë ato sipas meritave dhe nivelit ekonomik.

### 3.6 FONDE PËR SHKENCËN

Politika e këtij programi konsiston ne reformimin e sistemit të kërkimit shkencor. Menaxhimin e programeve të kërkimit shkencor dhe integrimin e kërkimit shkencor shqiptar me atë evropian. Integrimin e institucioneve dhe biznesit privat në veprimtari kërkimore shkencore.

## 4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2007

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2007. Këto produkte përbëjnë Planin e Monitorimit të Ministrisë.

### 4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Planifikimi dhe futja e sistemeve të menaxhimit me bazë performance në të gjitha institutet, qendrat dhe agjencitë që varen nga MASH.
- Zhvillimi i politikave të qarta për funksionet që MASH do të decentralizojë si dhe hartimi i udhëzimeve dhe akteve nënligjore përkatëse për DAR, ZA dhe shkollat lidhur me funksionet e decentralizuara.
- Fillimi i funksionimit të EMIS në nivel qendror.
- Zhvillimi i politikave të qarta për reformimin e sistemit të financimit dhe rritjen e kapaciteteve përkatëse në të gjitha nivelet.
- Miratimi dhe/ose amendimi i ligjeve dhe akteve nënligjore për të nxitur shkollat që të vjelin të ardhura nga shërbimet.
- Zhvillimi dhe diskutimi i modelit të financimit për nxënës.

Produktet që do të ofrohen

- 86 sisteme të vlerësimit sipas kriterit të performancës.
- 1 projekt pilot për decentralizimin.
- 24 Institucione Arsimore të lidhura në rrjet kompjuterik.
- 3000 mësues të trajnuar në përdorimin e TIK.
- 110 Shkolla të inspektuara dhe të audituara.
- Menaxhimi i politikave në sistemin arsimor.
- Menaxhimi i politikave arsimore në institucione.

### 4.2 ARSIMI BAZE (PËRFSHI PARASHKOLLORIN)

Objektivat e politikës

- Ndërtime të reja shkollore dhe rehabilitimi i atyre ekzistuese, kryesisht në zonat urbane, duke zvogëluar me 20% numrin e përgjithshëm të nxënësve të arsimit bazë që mësojnë në kushte të papërshtatshme dhe sigurimi i transportit të mësuesve dhe nxënësve.
- Hartimi i kurrikulës së re (programe dhe tekste) për klasën e IV, V, VIII dhe IX të arsimit të detyruar 9-vjeçar.
- Vlerësimi ndërkombëtar mbi bazë kampioni i arritjeve të nxënësve shqiptarë të moshës 15-vjeçare, krahasuar me ato të vendeve të tjera pjesëmarrëse (PISA 2009).
- Vlerësimi i dytë kombëtarë mbi bazë kampioni i arritjeve të nxënësve të klasës së IV fillore në lëndët matematikë, gjuhë shqipe dhe lexim (monitorim i treguesve të performancës së nxënësve).
- Shtimi dhe përmirësimi i pajisjeve shkollore të reja dhe mjete për mirëmbajtjen e tyre, pajisje laboratorike për shkencat natyrore, mjete didaktike, kompjuterë dhe biblioteka duke mbuluar 30% të nxënësve.
- Të pajisen 100% e numrit të nxënësve me tekste shkollore.

- Trajnimi i mësuesve në shërbim për kurrikulën e re të klasave IV dhe VIII. Trajnimi i mësuesve të lëndëve të veçanta në konvertimin e tyre në mësues shumëlëndësh për nivelin fillor, në masën 50%.
- Rritja e pagës së mësuesve në mënyrë të diferencuar, në total në masën 20-25%.
- Rritja e pjesëmarrjes në Arsimin Parashkollor duke arritur tërheqjen e 52% të grup moshës 3-6 vjeç.

Produktet që do të ofrohen

- 5 kopshte të reja me ushqim dhe pa ushqim në qytete mesatarisht me 8 grupe çdo kopsht.
- 15 kopshte të rehabilituara.
- 578.110 nxënës do të ndjekin arsimin baze.
- 360 Klasa të reja të ndërtuara.
- 635 Klasa të rikonstruara.
- 280 Shkolla të pajisura me sistem informatizimi dhe pajisje mobilieri, si dhe trajnim i mësuesve të kabinetëve.
- 25 Shkolla 9 vjeçare të pajisura baze laboratorike (aplikativë ku punohet në grup).
- 25 Shkolla 9 vjeçare të pajisura me pajisje mobilierie për laboratorë.
- 350 Klasa të ndërtuara dhe rehabilituara në qytetin e Tiranës.
- 1190 Shkolla ku do të informatizohen amzat.
- 56.000 nxënës të testuar në arsimin baze.
- 9000 nxënës të testuar të shpërndarë në 300 shkolla.
- 80 libra shkollorë të publikuar dhe të shpërndarë për Arsimin Baze.
- 44 Kurrikula të reja të hartuara.

### 4.3 ARSIMI I MESËM (I PËRGJITHSHËM)

Objektivat e politikës

- Tërheqja në arsimin e mesëm e 82% të nxënësve që mbarojnë arsimin e detyrueshëm.
- Zbatimi i programeve dhe teksteve të profilizimit në klasën e 12 të arsimit të mesëm të përgjithshëm me kohë të plotë si dhe trajnimi i të gjithë mësuesve që do zbatojnë kurrikulën e re.
- Përcaktimi i perspektivës kurrikulare në shkollat e mesme të përgjithshme mbi sistemin e detyruar nëntëvjeçar; përcaktimi i niveleve përfundimtare të ciklit dhe i niveleve për secilën lëndë dhe për çdo klasë të saj si dhe hartimi i planit mësimor përkatës.
- Ndërtime dhe rehabilitime shkollash, me prioritet zonat urbane, për të ulur numrin e nxënësve për klasë dhe arritjen e standardeve optimale pune.

Produktet që do të ofrohen

- 128.520 nxënës që ndjekin arsimin e mesëm të përgjithshëm.
- 150 Klasa të reja të ndërtuara.
- 100 Klasa të reja të ndërtuara në qytetin e Tiranës.
- 196 Klasa të rikonstruara.
- 233 Klasa të furnizuara me pajisje shkollorë.

- 65 Shkolla të pajisura me Kabinete Informatike, si dhe trajnim i mësuesve të kabineteve.
- 65 Shkolla të furnizuara me pajisje për Kabinetet e Informatikës.
- 12 Shkolla të pajisura me Laboratorë të rinj (aplikativë).
- 12 Shkolla të furnizuara me pajisje për Laboratorë të rinj të fizikes, kimisë e biologjisë.
- 78 Tekste të reja shkollore të publikuara dhe shpërndare për klasat 11 dhe 12.
- 58 Programe edukimi të zhvilluara (për arsimin e mesëm të përgjithshëm me kohë të shkurtuar dhe atë social-kulturor).

#### 4.4 ARSIMI I MESËM (PROFESIONAL)

Objektivat e politikës

- Përfshirja në arsimin profesional e social kulturor i 26% të nxënësve që vazhdojnë arsimin e mesëm.
- Rehabilitimi i 20% të shkollave ekzistuese dhe pajisja e tyre me mjete didaktike e laboratorike, me synim rritjen e cilësisë së mësimdhënies.
- Shtrirja e kurrikulës me dy nivele në 8 shkolla dhe hartim kurrikulash të reja.
- Parapërgatitja e kurrikulës së re. Trajnimi i mësuesve e drejtuesve.

Produktet që do të ofrohen

- 20.000 nxënës që do të ndjekin arsimin e mesëm profesional.
- 68 klasa të rehabilituara.
- 29 klasa të reja të ndërtuara.
- 11 konvikte të rehabilituara.
- 15 Shkolla të pajisura me Kabinete Informatike dhe Pajisje, si dhe trajnim i mësuesve të kabineteve.
- 2 Shkolla të kompletuara me Laboratorë të rinj fizike, kimie dhe biologjie.
- 52 Programe e Kurrikula të hartuara.
- 40 tekste shkollore të hartuar dhe publikuar.

#### 4.5 ARSIMI UNIVERSITAR

Objektivat e politikës

- Rritja e numrit të studentëve me kohë të plotë 10% dhe ulja e numrit të studentëve me kohë të pjesshme.
- Zgjerohet cikli i dytë i studimeve master nëpërmjet pilotimit në dy universitete.
- Standardizimi i kurrikulave në 30% të degëve të studimit.
- Akreditimi i 25% të diplomave

Produktet që do të ofrohen

- 76.000 studente do të ndjekin studimet universitare.
- 19.000 studente që përfitojnë akomodim dhe burse.
- 23 godina Fakultetesh të rehabilituara.
- 7 godina Fakultetesh të ndërtuara.

- 4 konvikte të rehabilituara me financimin e tyre.
- 1 bibliotekë e rehabilituar.
- 11 Fakultete të pajisura me Kabinete te Informatikës.
- 2 Universitete ku do të krijohet rrjeti telematik dhe 15 Fakultete të furnizuara me pajisje laboratorike.
- 3 Fakultete me kushte të përmirësuara te mësimit.
- 40 Diploma të akredituara

## **4.6 FONDE PËR SHKENCËN**

### Objektivat e politikës

- Strategjia dhe implementimi i platformës për reformimin e sistemit të kërkimit shkencor.
- Ristrukturimi i institucioneve të kërkimit shkencor dhe legjislacioni i ri për sistemin e kërkimit shkencor si edhe aktet normative të administrimit të tyre.
- Rritje me 15 % të buxhetit për programet kombëtare.
- Rritje me 15% të buxhetit për programet ndërkombëtare (dypalëshe dhe shumëpalëshe) në bashkëpunim me struktura dhe iniciativa evropiane të kërkimit shkencor. Zgjerim i marrëveshjeve dypalëshe me Kosovën dhe Slloveninë.
- Zgjerimi i aktiviteteve për përfshirjen e biznesit privat në programet kombëtare të kërkimit dhe zhvillimit, në marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe, si dhe financimi i projekteve.

### Produktet që do të ofrohen

- 60 projekte të Programeve kombëtare te kërkimit shkencor te financuara.
- 2 projekte të rëndësisë se veçante të financuara.
- 110 projekte të financuara në kuadër të Programeve Bilaterale.

Tabela Buxheti 2007 sipas programeve dhe llojeve te shpenzimeve, milion Lek

| Programet                               | Pagat dhe kontribute e sigurimeve shoqerore<br>600, 601 | Mallra dhe sherbime<br>602 | Subveconet<br>603 | Te tjera transferte korrente<br>604, 605 | Transferta per buxhetet familiare dhe individet<br>606 | Shpenzime kapitale<br>230, 231 | Total         |
|-----------------------------------------|---------------------------------------------------------|----------------------------|-------------------|------------------------------------------|--------------------------------------------------------|--------------------------------|---------------|
| Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi | 432                                                     | 210                        | 0                 | 0                                        | 0                                                      | 15                             | 657           |
| Arsimi baze (përfshire parashkollorin)  | 13,080                                                  | 890                        | 260               | 0                                        | 0                                                      | 3,322                          | 17,552        |
| Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)         | 3,091                                                   | 135                        | 40                | 0                                        | 0                                                      | 1,410                          | 4,676         |
| Arsimi i mesëm (profesional)            | 1,596                                                   | 281                        | 10                | 0                                        | 0                                                      | 460                            | 2,347         |
| Arsimi universitar                      | 3,301                                                   | 603                        | 380               | 6                                        | 360                                                    | 1,870                          | 6,520         |
| Fonde për shkencën                      | 0                                                       | 40                         | 0                 | 0                                        | 0                                                      | 150                            | 190           |
| <b>Total</b>                            | <b>21,500</b>                                           | <b>2,159</b>               | <b>690</b>        | <b>6</b>                                 | <b>360</b>                                             | <b>7,227</b>                   | <b>31,942</b> |

## 5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

| Treguesit                                                                             | Njësia | Qëllimi |
|---------------------------------------------------------------------------------------|--------|---------|
| <b>Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi</b>                                        |        |         |
| Numri i sistemeve të vlerësimit sipas kriterit të performancës                        |        | 86      |
| Numri i projekteve pilot për decentralizimin                                          |        | 1       |
| Numri i Institucione Arsimore të lidhura në rrjet kompjuterik                         |        | 24      |
| Numri i shkollave të inspektuara dhe të audituara                                     |        | 110     |
| Numri i kopshteve të reja me ushqim dhe pa ushqim                                     |        | 5       |
| Numri i kopshteve të rehabilituara                                                    |        | 15      |
| <b>Arsimi baze</b>                                                                    |        |         |
| Numri i nxënësve të regjistruar                                                       |        | 578 110 |
| Numri i klasave të ndërtuara dhe të rikonstruara                                      |        | 1345    |
| Shkolla 9 vjeçare të pajisura me laboratorë                                           |        | 25      |
| Libra shkollore të publikuar dhe të shpërndare për Arsimin Baze                       |        | 80      |
| Kurrikula të reja të hartuara                                                         |        | 44      |
| <b>Arsimi i mesëm (i përgjithshëm)</b>                                                |        |         |
| Numri i nxënësve të regjistruar                                                       |        | 128 520 |
| Numri i klasave të ndërtuara dhe të rikonstruara                                      |        | 250     |
| Klasa të furnizuara me pajisje shkollore                                              |        | 233     |
| Shkolla të pajisura me kabinete informatike                                           |        | 65      |
| Shkolla të pajisura me laboratorë të rinj dhe të furnizuara me pajisje për laboratorë |        | 12      |
| Tekste të reja shkollore të publikuar dhe të shpërndare për klasat 11 dhe 12          |        | 78      |
| Programe edukimi të zhvilluara                                                        |        | 58      |
| <b>Arsimi i mesëm (profesional)</b>                                                   |        |         |
| Numri i nxënësve të regjistruar                                                       |        | 33 000  |
| Numri i klasave të ndërtuara dhe të rikonstruara                                      |        | 98      |
| Shkolla të pajisura me kabinete informatike dhe pajisje                               |        | 15      |
| Shkolla të pajisura me laboratorë                                                     |        | 2       |
| Konvikte të rehabilituara                                                             |        | 11      |
| Tekste shkollore të hartuar dhe publikuar                                             |        | 40      |
| Programe e kurrikula të hartuara                                                      |        | 52      |
| <b>Arsimi universitar</b>                                                             |        |         |
| Numri i studenteve të regjistruar                                                     |        | 76 000  |
| Numri i studenteve që përfitojnë akomodim dhe burse                                   |        | 19 000  |
| Numri i godinave të ndërtuara dhe të rikonstruara                                     |        | 30      |
| Fakultete të pajisura me kabinete informatike                                         |        | 11      |
| Fakultete të furnizuara me pajisje laboratorike                                       |        | 15      |
| Konvikte të rehabilituara                                                             |        | 1       |
| Biblioteka të rehabilituara                                                           |        | 1       |
| Diploma të akredituara                                                                |        | 40      |
| <b>Kërkimi shkencor</b>                                                               |        |         |
| Programe kërkimi shkencor të financuara                                               |        | 55      |
| Projekte të rëndësishme të veçante të financuara                                      |        | 4       |
| Projekte të financuar në kuadër të Programeve Bilaterale                              |        | 125     |

## Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

Gjatë 3-mujorit të fundit të vitit 2006 dhe gjatë vitit 2007 janë planifikuar për t'u punuar dhe për t'u paraqitur për miratim projektaktet e mëposhtme:

### Në fushën e arsimit profesional

- VKM për veprimtarinë ekonomike me përfitime financiare të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional dhe përdorimin e të ardhurave të përftuara nga këto veprimtari
- VKM "Për modalitetet e kryerjes së praktikave në ndërmarrje nga nxënësit e shkollave profesionale dhe teknike dhe kursantët e qendrave të formimit profesional"
- VKM "Për veprimtaritë ekonomike të institucioneve të AFP dhe menaxhimin e të ardhurave prej tyre"

### Në fushën e arsimit parauniversitar

- Rishikimi i Ligjit Nr. 7952, dt. 29. 06.1995 "Për sistemin arsimor para universitar" (i ndryshuar)
- VKM 120, date 27.1.1997 "Për shpërblimin e autoreve të veprave shkencore, teksteve shkollore dhe materialeve të tjera të dokumentacionit shkollor"
- Rishikimi VKM nr. 144, datë 8.03.2006 "Për botimin, shtypjen dhe shpërndarjen e teksteve shkollore në arsimin parauniversitar"
- Projektvendim KM për zbatimin e TIK në rritjen e cilësisë së transmetimit dhe përvetësimit të njohurive në implementimin e metodave bashkëkohore evropiane në mësim

### Në fushën e arsimit të lartë

- Ligji i Arsimit të Lartë
- VKM për tarifën e shkollimit në sistemin master pasuniversitar dhe doktoraturë
- VKM për kuotat e pranimit dhe tarifën e shkollimit në Shkollat e Larta në sistemin me kohë të plotë për vitin akademik 2007-2008
- VKM për pranimet në Shkollat e Larta
